



Republika Kosova - Republic of Kosovo

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY**

<b>DATË/A:</b>	02/10/2015
<b>REFERENC-Ë:</b>	AKK – DPK - DPKPP – 03-03/2954/15
<b>PËR/ZA/TO:</b>	z. Ibrahim HOXHA Menaxher i Prokurimit - Komuna Podujevë
<b>CC:</b>	z. Agim VELIU Kryetar – Komuna Podujevë
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Hasan PRETENI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Opinion lidhur me tenderin: “Ndërtimi i kolektorit të ujërave të zeza përgjatë lumit Dumnica”



I nderuar z. HOXHA,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin: “Ndërtimi i kolektorit të ujërave të zeza përgjatë lumit Dumnica” me numër prokurimi: 615/15/154/521, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

**OPINION**

Në lidhje me Tenderin: “Ndërtimi i kolektorit të ujërave të zeza përgjatë lumit Dumnica” me numër prokurimi: 615/15/154/521, në mënyrë që të procedohet në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042.

## Arsyetim

Autoriteti Kontraktues, Komuna e Podujevës, bazuar në nevojën për ndërtimin e kolektorit të ujërave të zeza të lumit Dumnica, ka paraparë aktivitet prokurimi me Procedurë të Hapur. Aktiviteti i prokurimit në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik është shpallur më datë: 25/09/2015.

Agjencia kundër Korrupsion ka identifikuar se Komuna e Podujevës, si Autoritet Kontraktues gjatë përpilimit të dosjes së tenderit nuk ka dhënë vëmendjen e duhur, ku edhe janë bërë disa shkelje që bien ndesh me legjislacionin për Prokurim Publik.

Në Dosjen e Tenderit, ndërtimi i kolektorit të ujërave të zeza përgjatë lumit Dumnica, në SEKSIONI II, FLETA E TË DHËNAVE TË TENDERIT, tek pika 8.1 nënpika 1, kërkohet që: *“OE duhet të posedoi qarkullim bankar për periudhën tre vjeçare (2012,2013,2014), minimum 500,000.00€”*. Autoriteti Kontraktues me kërkesën për qarkullim prej 500.000,00 € ka kaluar kufizimin sipas UA-02/2014. Udhëzimi përkufizon se Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë qarkullim financiar për tre vitet e fundit shumë të caktuar e cila nuk duhet të kalojë dy herë vlerën e parashikuar të Projektit.

Po ashtu në Dosjen e Tenderit, në SEKSIONI II, FLETA E TË DHËNAVE TË TENDERIT, tek pika 9.1 Kërkesat mbi mundësinë teknike dhe/ose profesionale, nënpika 1, kërkohet që: *“Referenca për punë – ndërtim i kanalizimeve, kolektorëve, minimumi i vlerës së referencave për periudhën trevjeçare (2012, 2013, 2014) 370,000.00€. Në rast të formimit të konzorciumit, lideri duhet të posedoi 60% të vlerës së referencave”*. Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë që Operatori Ekonomik ose Grupi i Operatorëve Ekonomik të ketë realizuar punët e natyrës së ngjashme, edhe atë mund ta kërkojë për periudhën e tre viteve të fundit duke i vendosur edhe një vlerë të caktuar të projekteve, por e cila nuk mund të tejkalojë 1.5 herë vlerën e parashikuar të kontratës dhe në asnjë mënyrë të paracaktohet përqindja në mes anëtarëve të grupit siç është vepruar në këtë rast që *lideri duhet të posedoi 60% të vlerës së referencave*. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues në lidhje me Përshtatshmërinë Profesionale, Gjendjen Ekonomike dhe Financiare si dhe Aftësitë Teknike dhe/ose Profesionale kërkohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit. Kërkesa në dosje të tenderit që lideri i grupit duhet të posedoi 60% të vlerës së referencave është kërkesë e kundërligjshme dhe si e tillë duhet të ndryshohet nga Autoriteti Kontraktues për të vazhduar me aktivitetin e prokurimit.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë që bien ndesh me UA-02/2014, si dhe Nenin 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi; Nenin 27 Dosja e Tenderit; dhe Nenin 71 të Ligjit për Prokurimin Publik.





Agjencia Kundër Korrupsion i rekomandon Autoritetit Kontraktues që të marr hapat e nevojshëm për evitimin e kritereve diskriminuese të lartë cekura dhe të veprojnë në pajtim me ligjin e Prokurimit gjatë vazhimit të aktivitetit në fjalë.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !